



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 308, datë 18.06.2024
PËR**

**PËRSËRITJEN E KOMANDIMIT TË GJYQTARES ZNJ. {...}
NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË MBËSHTETËSE TË
KOMISIONEVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 dhe 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 200, datë 12.05.2021 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, pasi shqyrtoi Kërkesën e znj. {...}, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3213prot., datë 13.06.2024, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësine Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dy vjeçar.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 21.06.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR